

INSTITUTI PËR POLITIKË EVROPIANE - SHKUP

FLUTURIMI NË VEND OSE RËNIA E LIRË

Koment
lidhur me
Raportin e Komisionit Evropian
për Republikën e Maqedonisë

nga data 9 nëntor

10 nëntor 2016, Shkup

Instituti për Politikë Evropiane – Shkup

Dr. Malinka Ristevska Jordanova

Dr. Simonida Kacarska

Mr. Ardita Abazi Imeri

Mr. Kristina Dimova

Mr. Iva Conevska

Angel Mojsovski

Mr. Aleksandar Vançoski

Mr. Leposava Ognjanoska

Mr. Ismail Kamberi

Mariglen Demiri



REKOMANDIMI – “FLUTURIMI NË VEND”

Rekomandimi për hapjen e negociatave për integrimin në BE në Raportin e KE për Republikën e Maqedonisë nga viti 2016 është pezulluar dhe sërish i kushtëzuar, si edhe vitin e kaluar. Komisioni e kushtëzon rekomandimin për hapjen e negociatave me:

Marrëveshjet e Përzhinos dhe marrëveshja për zgjedhje janë mundësi për liderët e vendit përfundimisht ta tejkalojnë krizën e stërzgjatur, t’iu qasen problemeve sistemore të sundimit të së drejtës dhe vendi me vendosmëri t’i kthehet rrugës drejt BE.

progresin e implementimit të marrëveshjeve të Përzhinos, para së gjithash me mbajtjen e zgjedhjeve kredibile;

progresin e konsiderueshëm në implementimin e Prioriteteve Urgjente të Reformës.

Nëse bëjmë një krahasim me vitin e kaluar, Raporti e ilustron “fluturimin në vend” meqë (mungesa) e rekomandimit kishte paketim të njëjtë, me ç’rast këtë vit potencohet si kusht mbajtja e zgjedhjeve kredibile.

Në këtë mënyrë Komisioni e valorizoi Procesin e Përzhinos dhe Marrëveshjen për zgjedhje të parakohshme parlamentare në të cilat edhe institucionet evropiane investuan energji të konsiderueshme. Ashtu si edhe vitin e kaluar, është bërë një kompromis midis kritikave dhe nevojës që të ofrohet stimulimi për reforma përmes dhënies edhe të një shansi.

KE konsideron se këto procese janë “mundësi për liderët e vendit që përfundimisht ta tejkalojnë krizën e stërzgjatur, t’u qasen problemeve sistemore të sundimit të së drejtës dhe vendi me vendosmëri të kthehet në rrugën drejt BE-së.”

Rekomandimi që Qeveria t’i kthehet agjendës së BE-së është potencuar në vlerësimin se “sistemi koordinativ për integrimin evropian humb në cilësi për shkak të mungesës së vullnetit politik që të implementohen reformat që kanë të bëjnë me BE.”

Për dallim nga vendet e tjera të rajonit, të cilat shënojnë progres drejt BE-së, ne edhe në këtë vit, ashtu si edhe vitin e kaluar, shkujmë në drejtim të

Ku jemi në rajon?

Inëse bëjmë një krahasim me rajonin, për dallim nga vendet e tjera të cilët secili në mënyrën e vet shënon progres në rrugën drejt BE-së ne, këtë vit, si edhe vitin e kaluar lëvizim në drejtim të kundërt. Përderisa kushtet e tyre reduktohen, kushtet tona rriten. Për shembull, aktualisht Shqipëria, gjithashtu, ka rekomandim të kushtëzuar për hapjen e negociatave, por me shumë më pak kushte dhe më precize. Në rastin tonë, procesi është i kundërt, nga “rekomandimi i pastër” kushtet për ne zgjerohen.

REFORMAT NË RËNIE TË LIRË

Kriteret politike: shteti i kapur

Njëri nga vlerësimet më të rrepta të këtij viti është shqetësimi për **kapjen e shtetit** në institucionet, përfshirë këtu edhe institucionet gjyqësore, organet rregullatore dhe mediat, por edhe sektorë të rëndësishëm shoqërorë – kyç në fushën e qeverisjes, por që zë një vend të theksuar në konkluzionet e Strategjisë për zgjerim.

KE e vë në pikëpyetje funksionimin e sistemit të **lidhjeve dhe frerëve** në Republikën e Maqedonisë. KE vlerëson se Kuvendi nuk e kryen funksionin e vet për sigurimin e kontrollit mbi pushtetin ekzekutiv. Jurisprudenca nuk është e pavarur, ndërkaq autoritetet nuk kanë vullnet ta zgjidhin këtë çështje. Mbikëqyrja mbi pushtetin ekzekutiv nga trupat rregullator dhe mbikëqyrës është gjithashtu e kufizuar, meqë sipas KE ata nuk janë të lirë nga presionet politike.

Në vend të kësaj, **shoqëria civile** merr mirënjohje për rolin e rëndësishëm në mbështetje të proceseve demokratike dhe në sigurimin e sistemit të kontrollit dhe balancit. Roli i shoqërisë civile gjithnjë e më shumë theksohet në çdo raport të ri, me ç'rast veçanërisht vërehet iniciativa e grupit të organizatave qytetare për Reforma urgjente demokratike.

Shumë herë në Raport theksohet **mungesa e vullnetit politik të autoriteteve për zbatimin e reformave dhe Prioriteteve Urgjente të Reformave**. Në mënyrë plotësuese, mungesa e vullnetit politik është përcaktuar si shkas për **reduktimin e konsiderueshëm të ndihmës financiare nga BE** (27 milionë nga IPA për vitin 2016).

Për realizimin e **Prioriteteve Urgjente të Reformave** është konstatuar progres i kufizuar, megjithatë, dy vjet rresht, është konstatuar kthim pas në fushën kryesore të **gjyqësorit**.

Në lidhje me gjyqësorin dhe luftën kundër korrupsionit, KE potencon se në këto fusha reformat zbatohen tanimë një dekadë, por se ndikimi politik në mënyrë serioze i rrënon rezultatet paraprake. Në këtë mënyrë KE vë në dukje se Republika e Maqedonisë, një periudhë të gjatë iu paraprinte reformave, por aktualisht në rrjedhë e sipër janë procese të cilat i shkatërrojnë arritjet

Jurisprudenca: dekada e reformave u shkatërrua; - kthim pas dy vjet rresht

Kapacitetet e institucioneve të rregullta për luftimin e korrupsionit, në rastet e profilit të lartë sipas KE, janë rrënuar nga ndikimet politike. Në këtë drejtim, për herë të parë kërkohet revidimi i statusit dhe përbërjes së KSHPK në mënyrë që të rritet transparencja dhe pavarësia.

Nga ana tjetër, Prokuroria Speciale Publike (PSP) është organi i vetëm i cili vlerësohet si proaktiv në hetimet e rasteve të profilit të lartë, megjithatë ballafaqohet me mungesë të bashkëpunimit nga institucionet. Rrjedhimisht me këtë, KE rekomandon të sigurohen resurse dhe mbështetje të plotë për PSP.

Theksohet rëndësia e analizës së Marrëveshje Kornizë të Ohrit, e cila duhet të zbatohet në mënyrë transparente dhe inkluzive. VMRO-DPMNE deri më tani është distancuar nga analiza, megjithatë Komisioni sërish dhe sërish e kthen në agjendë.

Konform qasjes për t'iu kthyer bazave një pjesë jashtëzakonisht e madhe e Raportit i është përkushtuar **administratës publike** duke përcaktuar se politizimi i administratës dhe shfrytëzimi i sektorit publik si instrument i politikave akoma shqetëson.

Përveç asaj që korniza juridike për të drejtat e njeriut vite me radhë vlerësohet si solide, megjithatë specifikohen shkelje sistematike të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në burgje. Ky vlerësim është ngushtë i lidhur me kritikën e keqtrajtimit policor të cilat gjithashtu vite me radhë përsëriten, dhe prandaj KE rekomandon inkorporimin e mekanizmit të pavarur për mbikëqyrje.

Pasqyra e rekomandimeve të kritereve politike për vitin 2015 dhe 2016 është prezantuar në Aneksin 1.

Pasqyra e vlerësimeve të kritereve politike nga viti 2011 deri në vitin 2016 është prezantuar në Aneksin 2.

Kriteret ekonomike: nuk ka progres

Gjatë këtij viti pjesa e kritereve ekonomike është trajtuar në mënyrë më të detajuar, konform kontekstit në Ballkanin Perëndimor dhe në mënyrë plotësuese është harmonizuar me programet nacionale për reforma ekonomike.

Kombinim joadekuat i politikave të Qeverisë

Edhe në kriteret ekonomike, KE konstaton se nuk ka progres. Kur do të krahasohen raportet e para disa viteve, Maqedonia atëbotë ishte më afër fitimit të statusit të ekonomisë së lirë të tregut.

Derisa edhe më tutje kemi vlerësim pozitiv për **stabilitetin makroekonomik**, megjithatë janë akoma të pranishme plagët e vjetra të papunësisë së lartë (edhe përkrah reduktimit të përqindjes) si dhe konkurrenca e ulët në sektorin privat vendor. Përsëritet kritika nga viti i kaluar ndaj Qeverisë për politikën e diskrecionit të zbatimit.

Kritikat janë akoma më të ashpra për **rritjen e borxhit të jashtëm** të vendit – si atij publik, ashtu edhe privat. Përveç kësaj, këtë vit, Komisioni veçanërisht e nënvizon pjesëmarrjen e **ndërmarrjeve në pronë shtetërore** sa i përket rritjes së borxhit publik.

Kritika ndaj politikave ekonomike është eksplicite – nënvizohet se kombinimi i politikave nuk u përgjigjet plotësisht sfidave ekonomike.


KE është akoma më kritike se “Doing business”, kështu që edhe më tej konsideron se (mos) zbatim i marrëveshjeve është problem për mjedisin afarist.

Pasqyra e vlerësimeve të kritereve ekonomike është prezantuar në Aneksin 3.

Detyrime nga anëtarësia (acquis): është reduktuar harmonizimi me të drejtën e BE


The new EU approach was introduced in 2015 and incorporated to these reports. This year the pilot areas also cover issues related to the economic development, such as free movement of goods, competition, transport and energy, areas under Chapter 24 (migrations, border control, asylum and fighting terrorism), as well as environment.

Maqedonia sot është më pak e përgatitur të anëtarësohet në BE sesa paraprakisht



Nuk ka të dhëna pozitive për statusin e asnjë kapitulli – përkundrazi, në një kapitull kemi ulje të notës sa i përket harmonizimit (mjedisi jetësor – nga “përgatitja prudente” në “nivel të caktuar të përgatitjes”). Tendencia e këtillë është evidente nga viti 2014, kur u reduktua shkalla e harmonizimit edhe për Kapitullin e “Prokurimeve publike”, në të cilin këtë vit është konstatuar se nuk ka progres. Ky Kapitull është veçanërisht i rëndësishëm për sundimin e së drejtës.

Sipas kësaj, analiza e nivelit të harmonizimit të së drejtës të Republikës së Maqedonisë me të drejtën e BE-së, sipas Raportit të KE, vë në dukje tendencë të reduktimit. Ky është aspekti i vetëm i procesit në të cilin paraprakisht para shteteve të tjera, por tani edhe këtë “përparësi” e humbasim. Në shumicën e kapitujve nga e drejta e BE-së vlerësimi për harmonizim është “përgatitje prudente”, por edhe se ka progres të kufizuar ose nuk ka progres nga viti i kaluar.



Komisioni Evropian këtë vit përsëri nuk e ka vlerësuar asnjë kapitull me nivel të lartë të përgatitjes.

Pasqyra e vlerësimeve për ndërmarrjen e detyrimeve nga anëtarësia sipas kapitullit është prezantuar në Aneksin 4¹, ndërsa sqarimet e vlerësimeve janë prezantuar në Aneksin 5.

¹ Në pasqyrë është bërë valorizim numerik i vlerësimeve nga vitet e kaluara në mënyrë që të harmonizohet me metodologjinë e re të KE dhe të sigurohet komparacioni.

IPA: Siç janë reformat, e tillë është edhe mbështetja

Nga IPA I (610 milionë euro) nuk janë absorbuar 117 milionë euro, me probabilitet se kjo shifër do të rritet. IPA II shteti akoma nuk ka filluar ta realizoj. Komisioni, si problem kryesor për shfrytëzimin e fondeve të IPA, e identifikon paaftësinë dhe mospasjen e vullnetit tek Qeveria për reforma esenciale në “fushat kyç”. Për këtë shkak BE mjetet nga IPA 2016 i reduktoi për 27 milionë euro.

Nuk ka as vullnet e as aftësi të shfrytëzohen fondet evropiane

PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE

- 1.Republika e Maqedonisë është vendi i vetëm në rajon i cili shënon rënie sa u përket reformave në të tre kriteret e integritit në BE.
- 2.Raporti jashtëzakonisht kritik akoma ofron shtytje, përmes mundësisë së “jetësimit” të rekomandimit për negociata, por i kushtëzuar me një listë të gjatë të detyrimeve reformuese, krahas zgjedhjeve kredibile në dhjetor të vitit 2016.
- 3.Vetëm një Qeveri me platformë serioze reformuese dhe me kapacitete për zbatimin e saj, e cila do t'i qaset ndërtimit të vizionit dhe programit për ndryshime në shoqërinë maqedonase, do të jetë në gjendje ta ndërpresë rrugën e tatëpjetë të shtetit të ilustruar edhe në këtë Raport të BE-së.

Anekse:

Aneksi 1: Pasqyra e rekomandimeve të kritereve politike 2015 - 2016	9
Aneksi 2: Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve të kritereve politike 2011 - 2016	17
Aneksi 3: Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve të kritereve ekonomike 2011-2016	42
Aneksi 4: Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve të përmbushjes së detyrimeve nga anëtarësia 2011-2016	58
Aneksi 5: Metodologjia e vlerësimeve	61

Shtojca 1: Pasqyra e rekomandimeve të kriterëve politike për 2015 - 2016

2.1. Demokracia

Zgjedhje

2015

-Zbatimi i plotë i rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it para mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme

2016

-Parandalimi i frikësimit të qytetarëve dhe hetime për rastet e këtilla, ndarja e shtetit nga aktivitetet partiake, raportim i balancuar mediatik dhe azhurnim i vazhdueshëm i Listës së Zgjedhësve, zbatim i rekomandimeve nga OSBE/ODIHR, me qëllim të mbajtjes së zgjedhjeve kredibile.

-Fuqizimi i kapaciteteve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, transparencë më e madhe dhe rritje e besimit të qytetarëve në punën e tij.

Parlamenti

- Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Hetimor për ngjarjet e ndërlidhura me 24 dhjetor 2012

Përmirësim i konsiderueshëm i legjislacionit dhe funksionit mbikëqyrës, si dhe përmirësim i efikasitetit të Parlamentit si forum për dialog politik konstruktiv dhe përfaqësim. Fokusi duhet të vihet në pjesëmarrjen aktive të të gjitha partive parlamentare, konsultimin përkatës dhe vlerësimin e ndikimit para miratimit të legjislacionit, mbikëqyrjen kredibile mbi punën e qeverisë dhe shërbimet inteligjente, sigurim i përgjegjësisë politike për përgjimet jolegale dhe monitorim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vend.

Shtojca 1: Pasqyra e rekomandimeve të kriterëve politike për 2015 - 2016

2.1. Demokracia	Qeverisje	
2015	2016	
	<p align="center">-Qeveria doemos duhet ta rikthej kredibilitetin e vet përmes zbatimit të reformave energjike.</p>	
<p>- Të gjithë rregullatorët e pavarur, mbikëqyrësit dhe organet këshilluese duhet të jenë në mundësi t'i shfrytëzojnë autorizimet e tyre në mënyrë proaktive dhe efektive, pa presion të jashtëm e pa shfrytëzim të papërshtatshëm politik vetë-kufizues ose interpretim të mandateve të tyre në formë zyrtare. Këta organe përfshijnë: Komisionin shtetëror të zgjedhjeve, Komisionin shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencisë për audio dhe shërbime audio-vizuale, Avokatin e Popullit, Këshillin Gjyqësor, Këshillin e prokurorëve publikë dhe Revizori Shtetëror.</p>		
	<p>Përgatitja dhe mbajtja e zgjedhjeve kredibile, kryerja dhe zbatimi i të gjitha obligimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Përzahinos.</p>	
	<p>Marrëveshja Kornizë e Ohrit duhet të shqyrtohet në mënyrë inkluzive dhe transparente dhe duhet të zbatohen rekomandimet të cilat do të rezultojnë nga shqyrtimi.</p>	

Shtojca 1: Pasqyra e rekomandimeve të kriterëve politike për 2015 - 2016

2.1. Demokracia

Shoqëria civile

2015

2016

Protagonistët qeveritarë duhet ta inkuadrojnë shoqërinë civile në krijimin e politikave dhe ligjeve bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive.

Protagonistët qeveritarë dhe joqeveritarë duhet të bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive.

Shteti doemos duhet të sigurojë kornizë relevante juridike, financiare dhe politike në mënyrë që të sigurohet funksionimi i shoqërisë civile.

Mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit

Nuk janë dhënë rekomandime konkrete, por raportohet se Prioritetet Urgjente të Reformave akoma nuk janë zbatuar.

Shtojca 1: Pasqyra e rekomandimeve të kriterëve politike për 2015 - 2016

2.2. Reforma e administratës publike

2015	2016
-ta adresojë shqetësimin serioz për politizimin e shërbimit publik, zbatimin e plotë të parimeve të përgjegjësisë, transparencës dhe meritës, duke e përfshirë zbatimin e një sistemi të përmisuar, sistem informacioni për menaxhimin me burimet njerëzore.	të adresohet shqetësimi serioz lidhur me politizimin e shërbimit publik, zbatim i plotë i parimeve të përgjegjësisë, transparencës dhe meritës (PUR)
Pezullimi dhe rishikimi i Ligjit për transformimin e kontratave të përkohshme në të përhershme, derisa parimi meritor nuk është plotësisht i përfshirë.	të suspendohet dhe shqyrtohet zbatimi i Ligjit për transformimin e pozicioneve të përkohshme në kontrata të përhershme deri në përbushjen e plotë të parimit të meritave (PUR),
Miratimi i strategjisë për administratën publike dhe menaxhimin me financat publike, me çka duhet të adresohen dobësitë e identifikuara, duke përfshirë edhe transparencën buxhetore.	të miratohet Strategjia për reformën e administratës publike dhe Programi për reformat për menaxhimin me financat publike, me ç'rast duhet të adresohen dobësitë e identifikuara, përfshirë edhe transparencën buxhetore.

2.3. Sundimi i së drejtës

Jurisprudenca

2015	2016
	-depolitizimi i sistemit të emërimit dhe avancimit në praktikë, jo vetëm në ligj;
	- sigurimi i mbështetjes së plotë dhe resurse për punën e Prokurorisë Speciale Publike;
Reformimi i sistemit ekzistues i masave disiplinore dhe shkarkimi i gjyqtarëve	-Reformimi i sistemit ekzistues i masave disiplinore dhe shkarkimi i gjyqtarëve, në përputhje me rekomandimet e BE dhe Komisionit të Venecias;
Miratimi i strategjisë për administratën publike dhe menaxhimin me financat publike, me çka duhet të adresohen dobësitë e identifikuara, duke përfshirë edhe transparencën buxhetore.	-miratimi i Strategjisë serioze për reforma në gjyqësor dhe planit të veprimit me qëllim të adresimit të mangësive të tjera në mënyrë të qëndrueshme;
-të përmirësohet planifikimi strategjik, vlerësimi i nevojave, administrimi dhe shpërndarja e resurseve në kuadër të gjyqësorit,	-të përmirësohet planifikimi strategjik, vlerësimi i nevojave, administrimi dhe shpërndarja e resurseve në kuadër të gjyqësorit, përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë;

Shtojca 1: Pasqyra e rekomandimeve të kriterëve politike për 2015 - 2016

2.3. Sundimi i së drejtës

Lufta kundër korrupsionit

2015	2016
-demonstrimi i vullnetit të vërtetë politik për luftë kundëjt korrupsionit në formë të ndërmarrjes së masave të pavarura dhe efektive nga ana e organeve për zbatimin e ligjit dhe organeve mbikëqyrëse, në veçanti Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit;	demonstrimi i vullnetit politik të mirëfilltë për luftë kundër korrupsionit përmes sigurimit të pavarësisë së domosdoshme, personelit të specializuar dhe pajisjes, si dhe përmes përcaktimit të qëllimeve të qarta dhe indikatorëve për matjen e sukseseve dhe mossukseseve të organeve ligjzbatuese;
	revizion të statusit dhe përbërjes së KSHPK me qëllim të rritjes së transparencës, kompetencës dhe pavarësisë nga partitë politike;
-rritja e vizibilitetit të masave të anti-korrupsionit dhe rezultatet e arritura me qëllim për të përmisuar ndërgjegjësimin e opinionit dhe besimin;	rritja e vizibilitetit të masave anti-korrupsion dhe të rezultateve të arritura me qëllim të përmirësimit të vetëdijes publike dhe besimit;
-zhvillimi i dosjes së besueshmërisë të situatës në drejtim të korrupsionit të lartë;	zhvillimi i dosjes autentike për gjendjet në lidhje me korrupsionin e lartë, duke e përfshirë edhe prejardhjen e pronës (konform PUR)
- krijimi i një kuadri efektiv për mbrojtjen e treguesëve, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira.	- Implementimi i kornizës efektive ligjore për mbrojtjen e denoncuesve, në përputhje me standardet evropiane (në përputhje me (PUR) dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias recommendations.

Shtojca 1: Pasqyra e rekomandimeve të kriterëve politike për 2015 - 2016

2.3. Sundimi i së drejtës

Lufta kundër krimit të organizuar

2015

2016

Rivendosja e dosjes për luftë kundër larjes së parave dhe avancimi i kapaciteteve dhe ekspertizave për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e aseteve në bazë më sistematike

avancimi i dosjes për luftë kundër pastrimit të parave dhe avancimi i kapaciteteve dhe ekspertizës për zbatimin e hetimeve financiare dhe mjete për konfiskim në bazë më sistematike;

Përforcim i përpjekjeve për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive të ndryshme për zbatimin e ligjit përmes trajnimeve të plota të Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Luftë Kundër Krimit të Organizuar

të vendoset një mekanizëm i pavarur i jashtëm dhe transparent për mbikëqyrjen e policisë.

Rishikimi i kuadrit ligjor dhe teknik për ndjekjen e komunikimeve dhe rritjen e efektivitetit të masave të posaçme hetimore për zbatimin vërtetë e objektivave ligjore (prioritetet urgjente të reformave

përforcimi i përpjekjeve për përmirësimin e bashkëpunimit midis agjencive të ndryshme ligjzbatuese përmes aftësimit të plotë të Qendrës Koordinative Nacionale për luftë kundër krimit të organizuar;

Revidimi i kornizës juridike dhe teknike për ndjekjen e komunikimeve dhe rritjen e efektivitetit të masave speciale hetuese për zbatimin e mirëfilltë të objektivave të ligjit (PUR).

Shtojca 1: Pasqyra e rekomandimeve të kriterëve politike për 2015 - 2016

2.4. Të drejtat e njeriut

Liria e shprehjes

2015

2016

Sigurimi i transparencës së plotë mbi reklamat qeveritare dhe zhvillimi i mekanizmave për njoftime të papaguara të shërbimeve publike që janë me interes të mirëfilltë publik.

Të prezantohen rezultatet e prekshme nga reformat rrjedhëse në servisin radiodifuziv publik, të orientuara në drejtim të tejkalimit të mangësive të pavarësisë politike dhe raportimit të balancuar (PUR)

Garantimi dhe zbatimi i praktikës së vetë-limitimit përkatës në nivel politik nga ana e politikanëve dhe zyrtarëve publik që të mos ngritet procedurë për shpifje, në përputhje me principet e GJEDNJ.

Sigurimi i transparencës së plotë të reklamimit qeveritar, jo vetëm sa i përket shpenzimit të financave publike, por gjithashtu për marrësit dhe shfrytëzuesit (PUR)

Sigurim i qasjes ndaj opinionit mbi raportim objektiv dhe të saktë për mendime të ndryshme në mediat e shikuara, doemos në shërbimin publik të radiodifuzionit

Sigurimi i qasjes së publikut në drejtim të raportimit objektiv dhe të saktë për opinione të ndryshme në mediat vizive, veçanërisht në servisin radiodifuziv publik.

Të gjithë faktorët mediatik duhet të ndërmarrin përgjegjësi përkatëse për sjellje profesionale.

Shtojca 2: Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve të kriterëve politike 2011-2016

Kritere/ Nënkritere / Kapitulli	I.1.1. Demokracia dhe sundimi i së drejtës
2011	
2012	
2013	
2014	
2015	<p>2.1 Demokracia</p> <p>Vendi u ballafaqua me krizën më të rrëndë politike që nga viti 2001, kriza u thellua edhe më shumë me publikim e bisedave të përgjuara përfshirë edhe bartës të funksioneve të larta në qeveri të cilët sygjerojnë dëmtim të të drejtave fundamentale, ndikim mbi pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e mediave e zgjedhjeve, politizim dhe korpupsion në fusha të ndryshme. Shqetësimet lidhur me të gjitha këto çështje qenë të sinjalizuara në raportet e mëparshme të progresit. Si përgjegje e kësaj, Komisioni i publikoi prioritetet urgjente të reformave që pjesërisht bazohen në rekomandimet e mëparshme dhe pjesërisht në rekomandimet nga Grupa të ekspertëve të nivelit të lartë për sundimin e së drejtës. Komisioneri, me ndihmën e tre pjesëtarëve tjerë të Parlamentit Evropian, e lehtësonte marrëveshjen politike të periudhës qershor/korrik. Deri tani, jo të gjitha elementet e marrëveshjes janë zbatuar dhe një numër i madh i afateve kanë skaduar - janë shtyrë - пробиени.</p> <p>Liderët e partive politike janë të përkushtuar që ti zbatojnë të gjitha rekomandimet nga Komisioni për çështjet sistematike lidhur me sundimin e së drejtës (prioritetet urgjente të reformave), megjithatë, zbatimi filloi me një ritëm të ngadalshëm, pa rezultate konkrete deri më sot.</p>
2016	<p>2.1 Demokracia</p> <p>Periudha e raportimit u karakterizua me vazhdimin e krizës politike dhe me zbatimin e pjesshëm të Marrëveshjes së Përzahinos të arritur në vitin 2015. Edhe pse një pjesë e afateve u respektuan, megjithatë, pjesa më e madhe e tyre shënoi vonesa, kështu që ishte i domosdoshëm angazhimi i vazhdueshëm dhe mbështetja nga BE dhe SHBA. Disa elemente kyç të Marrëveshjes nuk u plotësuan. Edhe pse zgjidhja e një pjesë të tyre tanimë ka filluar, është shënuar progres i kufizuar në lidhje me implementimin konkret të "Prioriteteve Urgjente të Reformave", para së gjithash për shkak të mungesës së vullnetit politik. Kriza e thellë politike, e nxitur nga ndjekja jolegale e komunikimeve, si dhe serioziteti i përmbajtjeve të tyre, vazhdoi edhe në vitin 2016. Vendimi i Presidentit, që t'i falë 56 persona të akuzuar ose me pretendime se janë përfshirë në përgjimin e bisedave, u anulua nën presionin e protestave të fuqishme vendore dhe ndërkombëtare. Në përgjithësi, demokracia dhe sundimi i së drejtës edhe më tej do të ballafaqohen me sfida, veçanërisht për shkak të institucioneve "të kapura", siç janë institucionet gjyqësore, organet rregullatore dhe mediat. Vendi vuan nga kultura politike e përçarjes dhe mungesës së kapaciteteve për kompromis. Interesat e ngushtë partiak edhe më tutje mbisundojnë mbi interesat e shtetit dhe të qytetarëve të tij për çështjet kryesore. Vendimet dhe marrëveshjet e arritura në periudhën e kaluar, përfshirë këtu edhe datën për përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme kredibile parlamentare, janë një mundësi që liderët e vendit përfundimisht ta tejkalojnë krizën e stërzgatur, t'u përkushtohen çështjeve që kanë të bëjnë me sundimin sistemor të së drejtës, si dhe ta kthejnë vendin bindshëm në rrugën e BE-së.</p>

2011

2012

2013

nevojitet avancim cilësor i legjislacionit;
të dhënat e Komisionit të Venecias për Lustrim: aplikim i masave të lustrimit për një kohë të gjatë pas fillimit të demokratizimit, keqpërdorim i shkaqeve politike, ideologjike dhe partiake për masat e lustrimit

2014

Amendamentet kushtetuese ishin pa legjislacion shoqërues për implementimin e tyre.
Duhet të bazohen mbi konsensus të gjerë. BE bën analiza plotësuese të harmonizimit të legjislacionit me atë të BE.
Kohëve të fundit është vënë në pikëpyetje pavarësia e Gjykatës Kushtetuese.

2015

Qenë të propozuara amendamentet kushtetuese nga ana e Qeverisë për një gamë të gjërë fushash, pavarësisht mungesës së partisë kryesore opozitare në Parlament. Asnjë nga ndryshimet e propozuara dhe asnjë nga legjislacionet shoqëruese nuk qenë të miratuara nga ana e Parlamentit si pasojë e asaj që nuk mund të arrihej dy e treta e shumicës.

2016

2011	Progres në zbatimin e zgjedhjeve. Zgjedhjet ishin kompetitive, transparente dhe mirë të administruara në mbarë vendin.
2012	Legjislacioni është dërguar për shqyrtim në Kuvend
2013	Sipas OSBE-së zgjedhjet lokale u administruan në mënyrë efikase, por me tendencë të frikësimit të votuesve dhe keqpërdorimit të mjeteve shtetërore në fushatë. Vazhdon puna e grupeve të punës për rekomandimet e mbetura të OSBE-së për legjislacionin zgjedhor dhe Listën e Zgjedhësve.
2014	Sipas OSBE/ODIHR-së, zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare u administruan mirë, pa u penguar e drejta e tubimit. Vërehet distancimi i paqartë midis shtetit dhe partisë. Sugjerohet mjedisi i pabarabartë për garë politike ndërmjet kandidatëve politikë. Përsëritet shqetësimi për frikësimin e votuesve. Kritika mbi mediat dhe mënyrës së raportimit dhe mospasje e dallimit të qartë midis aktiviteteve të përfaqësuesve të pushtetit dhe kandidatëve politikë në zgjedhje. KSHZ-ja është vlerësuar mirë për administrimin e zgjedhjeve. Dy grupet e punës gjatë verës vazhduan me punë për adresimin e rekomandimeve nga OSBE/ODIHR.
2015	Mangësitë e ndërlidhura me zgjedhjet, paraprakisht të sinjalizuara nga OSBE/ODIHR dhe dyshime të tjera, qenë të reflektuara në përmbajtjen e bisedave të përgjuara. Prioritetet urgjente të reformave duhet të zbatohen.
2016	Në vigjilje të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, doemos duhet të vazhdohet me sigurimin e kushteve për një proces kredibil zgjedhor (siç është parandalimi dhe hetimi i frikësimit të votuesve, duke e siguruar ndarjen e shtetit nga aktivitetet partiake, raportimi u balancuar mediatik dhe përditësimi i vazhdueshëm i Listës së Zgjedhësve), si dhe të zbatohen rekomandimet e OSBE/ODIHR. Duhet të vazhdohet me angazhimet për përmirësimin e kapaciteteve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). Nevojitet transparencë më e madhe në mënyrë që të rritet besimi i qytetarëve në punën e KSHZ.

2011	Progres i caktuar.
2012	
2013	
2014	Përgjegjësia bie mbi Qeverinë dhe opozitën sa i përket sigurimit të debatit politik në Kuvend dhe sigurimit të kushteve për funksionimin e tyre.
2015	Ndërprerja e dialogut politik dhe vështirësitë që të arrihet konsensus për çështjet edhe njëherë e potencuan kulturën përçarëse në vend.
2016	Vendi vuan nga kultura politike e përçarjes dhe mungesës së kapaciteteve për kompromis. Interesat e ngushtë partiak edhe më tutje mbisundojnë mbi interesat e shtetit dhe të qytetarëve të saj për çështjet kryesore.

2011	Progres i caktuar
2012	Është ruajtur funksionimi i Kuvendit dhe dialogut politik; mbështetje e fuqishme e DANL
2013	Parlamenti u godit nga kriza e 24 dhjetorit dhe bojkoti i bllokut opozitar. Me rëndësi të jashtëzakonshme është të vazhdohet me punën e implementimit të rekomandimeve të kontraktuara. Duhet të përmirësohet dialogu midis partive politike në Kuvend.
2014	Funksionimi i Kuvendit u pengua nga mungesa e dialogut konstruktiv politik dhe ndarjes së thellë midis partive politike. Ekziston nevoja për vendosjen e kontrollit dhe balancimit mbi aktivitetet e Qeverisë nga ana e opozitës.
2015	Kriza ekzistuese ka nxjerr në pah nevojën për përmisim të konsiderueshëm të punës së Kuvendit si forum për dialog konstruktiv, përfaqësi dhe si funksion legjislativ dhe mbikëqyrës. Kjo duhet të përfshijë edhe mbikëqyrje funksionale kredibile rreth punës së shërbimeve të inteligjencës, kapaciteteve për të mbrojtur të drejtat njerëzore dhe lirive themelore në vend. Mungesa e partisë kryesore të opozitës në periudhën raportuese e zvogëlon cilësinë e reformave dhe e pengon sistemin kontrollues dhe të barazimeve (checks and balances)
2016	The ongoing crisis underlined once again parliament's weak legislative and oversight functions and the need to substantially improve its performance as a forum for constructive political dialogue and representation. The focus needs to be on active participation of all parliamentary parties, proper consultation and impact assessment prior to the enactment of legislation, credible functional oversight of the work of government and the intelligence services, establishing political accountability for the illegal wiretaps, and the capacity to monitor the protection of human rights and fundamental freedoms in the country.

2011	
2012	
2013	
2014	
2015	<p>Qeverisja në vend ishte e tensionuar me krizën aktuale politike dhe ishte e vënë në pyetje përmes shfaqjes së sjelljeve joetike, aktivitetet e paligjshme madje edhe vepra të mundshme penale.</p> <p>Vetëm një përgjegjësi e kufizuar politike ishte e ndërmarrë përmes dorëheqjes së dy ministrave dhe drejtorit të UBK-së.</p> <p>Mungesa e mbikëqyrjes mbi organet kryesore duhet të jetë e adresuar dhe të gjithë rregullatorët e pavarur, organet mbikëqyrëse dhe këshilluese duhet të jenë në gjendje t'i kryejnë funksionet e tyre në mënyrë proaktive, efektive dhe në formë të lirë nga presionet politike. Tensionet ndëretnike e nxjorën në pah nevojën për zbatim të plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.</p>
2016	<p>Sfidat serioze me qeverisjen demokratike të vendit vazhduan edhe më tutje dhe shkaktojnë shqetësime, meqë institucionet dhe sektorët kryesorë të shoqërisë janë të kapur. Organet e pavarura rregullatore, mbikëqyrëse dhe këshillëdhënëse nuk ishin në gjendje t'i kryejnë të gjitha funksionet e tyre në mënyrë proaktive, efikase dhe të çliruar nga presionet politike, e që rezultoi me mbikëqyrje të kufizuar të pushtetit ekzekutiv. Qeveria duhet ta kthejë kredibilitetin përmes zbatimit të reformave energjike, përgatitjes dhe organizimit të zgjedhjeve të besueshme, kryerjes dhe zbatimit të të gjitha obligimeve që rezultojnë nga Marrëveshja e Përzahinos. Qeveria e Maqedonisë arriti progres të kufizuar sa i përket zbatimit të "Prioriteteve Urgjente të Reformave", që e pranoi në qershor të vitit 2015. Kthimi pas vazhdon në disa fusha kritike të Sundimit të së Drejtës.</p>

2011	Dallime të tejkaluara, bashkëpunim i përfortuar
2012	Bashkëpunimi në koalicion ka vazhduar dhe ka arritur në vendosjen e procesit të aderimit në qendër të agjendës politike. Maturi në ballafaqimin me tensionet ndëretnike
2013	Qeveria ishte stabile dhe vazhdoi me përkushtimin e saj ndaj reformave që kanë të bëjnë me BE, të cilat mbeten lartë në agjendën e saj. Nevojitet qasje më e fuqishme e bazuar mbi konsensusin në politikë si dhe distancomi i partive politike dhe strukturave shtetërore.
2014	Qeveria e Maqedonisë duhet të funksionojë më mirë si njësi, me qëllim të ndërmarrjes së masave proaktive dhe të përbashkëta për përfortimin e besimit ndërmjet bashkësive në vend. Nënkryetari i Qeverisë për BE vazhdon të ketë rol kryesor në koordinimin e procesit të BE-së. Regjistrat administrativ, si zëvendësim të Regjistrimit të pasuksesshëm dhe metodologjia për zbatimin e tyre duhet të zbatohen me konsensus të gjerë politik. Qeveria e koalicionit duhet të aplikojë qasje të integruar, të koordinuar dhe transparente me qëllim të zbatimit të masave proaktive për çështje nacionale, ndëretnike dhe çështje të BE-së. Duhet të ndërmerren aktivitete për adresimin e rekomandimeve nga OSBE/ODIHR për shkrimin e shtetit me partitë në pushtet.
2015	Koalicioni qeveritar mes VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së mbeti stabil, por seriozisht u tensionua nga kriza. Në muajin maj, koalicioni humbi dy të tretat e shumicës. Decentralizimi i pushtetit është e një rëndësie të jashtëzakonshme dhe element kyç i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Një komunë (Pllasnica) nuk e ka përfunduar fazën e dytë të decentralizimit fiskal. Ka pasur progres specifik në miratimin e programit strategjik 2015-2020 për decentralizim dhe në planin e veprimit. Megjithatë, procesi i decentralizimit duhet të përmisohet.
2016	Konform Marrëveshjes së Përzghinos, ministrat e LSDM-së iu bashkëngjitën Qeverisë së përkohshme në muajin nëntor të vitit 2015, ndërsa zëvendës ministrat nga radhët e VMRO-DPMNE dhe LSDM u emëruan në disa ministri, me të drejtë të vetos, për çështje që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Megjithatë, obstrukcionet dhe mungesa e bashkëpunimit në këto ministri ndërpartiake u denoncuan nga të gjitha anët. Ekzistojnë angazhime të kufizuara qeveritare për dialog me organizatat joqeveritare. Përfshirja e tyre në krijimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit mbetet e pamjaftueshme, edhe pse disa impenjime plotësuese u bënë nga Sekretariati për Çështje Evropiane. 89 organizata qytetare shprehën shqetësim serioz në lidhje me procesin për formimin e Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil, veçanërisht në lidhje me mungesën e procesit përkatës konsultativ dhe procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile. Pushteti lokal akoma nuk ka kapacitete adekuate për bashkëpunim me organizatat joqeveritare.

2011

2012

2013

2014

Shoqëria civile e përforcuar është komponentë kritike për çdo sistem demokratik dhe roli i saj duhet të njihet dhe trajtohet në këtë mënyrë nga ana e pushtetit.

2015

Edhe pse është arritur progres specifik, organizatat e shoqërisë civile vazhduan ta shprehin me seriozitet shqetësimin e tyre për mjedisin e vështirë në të cilin ata veprojnë.

Ata raportojnë që janë subjekt i kritikave të ashpra nga ana e politikanëve dhe medimeve pro-qeveritare, si dhe që janë të kufizuar në angazhim për dialog.

Gjatë krizës politike në vitin 2015, GO shpesh herë luante roli konstruktiv përmes organizimit të një sërë protestash paqësore e që i tejkaloi linjat etnike dhe kërkuan përgjegjësi më të lartë nga politikanët.

Njëkohësisht, polarizimi politik dhe ndarja akoma mund të jetë e vrojtuar mes GO-së të cilët e mbështesin qeverinë dhe atyre që e kundërshtojnë. Autoritetet kombëtare duhet t'i kyçin organizatat e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes dhe legjislacionit në mënyrë të rregullt dhe efektive.

2016

Nuk ka progres në zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar. Mjedisi, në të cilin punojnë organizatat qytetare, është përkeqësuar. Organet nacionale duhet të konsultohen dhe të përfshihen në shoqërinë civile që të gjendet mënyra e zgjidhjes së krizës përmes përfshirjes më të mirë të organizatave qytetare në krijimin e politikave, në procesin e legjislacionit dhe në debatet të cilat duhet të rezultojnë me aktivitete konkrete. Edhe Qeveria edhe protagonistët joqeveritarë duhet të bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive. Shteti doemos duhet të siguroj kornizë relevante juridike, financiare dhe politike në mënyrë që të sigurohet funksionimi i shoqërisë civile.

2011

2012

2013

2014

2015

Në teori, vendi ka sistem për mbikëqyrje i cili nuk funksionon në praktikë. Nuk ekziston marrje e përgjegjësisë për dështimet serioze në shërbimet për inteligjencë për parandalimin e përgjimit të paligjshëm. Në këtë pjesë duhet të realizohen rekomandimet e prioriteteve urgjente të reformave.

2016

Dy komisionet mbikëqyrëse, me të cilat kryeson opozita (njëri për siguri dhe kundërzbulim dhe tjetri për ndjekjen e komunikimeve), e filluan punën e tyre në muajin shtator të vitit 2015. Ato e vizituan Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) dhe shërbimet e tjera, por nuk bënë kurrfarë mbikëqyrje efektive. Rekomandimet e qarta për mbikëqyrje dhe reforma në shërbimet inteligjente, në "Prioritetet Urgjente të Reformave" nuk janë zbatuar. Sistemi mbikëqyrës akoma nuk është plotësisht funksional, veçanërisht sa u përket shërbimeve inteligjente. Puna e reformave në sektorin e zbulimit përfundimisht filloi në tetor të vitit 2016 me mbështetje nga jashtë.

Kritere/ Nënkritere / Kapitulli

Administrata Publike

2011	Progres në kornizë, progres i kufizuar në implementim
2012	Progres i caktuar
2013	Vazhdoi puna e kornizës së re ligjvënëse për unifikimin e rregullave dhe inkorporimin e principeve të transparencës dhe meritës. Nevojiten përpjekje shtesë për avancimin e profesionalizmit dhe pavarësisë së administratës publike, si dhe përfaqësimin e drejtë.
2014	Administrata publike është fragmentizuar dhe është objekt i ndikimit politik edhe përkundër progresit të rregullimit normativ të fushës. Duhet të bëhen përpjekje plotësuese për sigurimin e principit të transparencës dhe përgjegjësisë, meritës dhe përfaqësimit të drejtë. Transparenca fiskale duhet të avancohet.
2015	Vendi është zhvilluar mesatarisht me reformën e administratës publike. Është bërë progres specifik në legjislacion dhe në përmisimin e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Shqetësimi rreth politizimit ishte i ngritur përmes përmbajtjes së materialeve të publikuara të përgjuara dhe vonës në zbatimin e plotë të kuadrit të ri ligjor. Është i nevojshëm vullneti i fortë politik për të garantuar pavarësinë e administratës dhe respektuar principet e transparencës, meritës dhe përfaqësimit të barabartë.
2016	Vendi është mesatarisht i përgatitur sa i përket reformës së administratës publike. Gjatë viteve të kaluara, edhe pse progres i kufizuar, megjithatë, ishte arritur një progres i caktuar. Filloi me implementimin e kornizës së re ligjore për menaxhimin me resurset njerëzore. Megjithatë, përkushtimi është i pamjaftueshëm për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit nga viti 2015. Linjat joefikase të përgjegjësisë, shfrytëzimi i sektorit publik si instrument politik, presionet e pretenduara mbi të punësuarit në sektorin publik dhe politizimi i pretenduar i administratës gjatë vitit elektorale vazhdojnë të jenë objekt i shqetësimit. Gjithashtu, mungesa e përkushtimit politik për realizimin e reformave të nevojshme, në menaxhimin me financat publike, rezultoi në reduktim të konsiderueshëm të mbështetjes financiare nga BE në vitin 2016. Nevojiten angazhime të fuqishme politike në mënyrë që të garantohet pavarësia e administratës publike dhe respektimi i parimeve të transparencës, meritës dhe përfaqësimit të drejtë. Gjatë vitit të ardhshëm, vendi në mënyrë të veçantë duhet: t'i përkushtohet shqetësimit serioz lidhur me politizimin e shërbimit publik; të sigurojë zbatim të plotë të parimeve të përgjegjësisë, transparencës dhe meritës (siç është parashikuar në "Prioritetet Urgjente të Reformave"), si dhe me ligj; ta suspendojë dhe rishikojë implementimin e Ligjit për transformimin e pozitave të përkohshme në kontrata të përhershme, përderisa parimi i meritës të respektohet plotësisht (si në/ konform "Prioritetet Urgjente të Reformave"); të miratojë strategji për reforma të administratës publike dhe program për reforma lidhur me menaxhimin me financat publike, të cilat do të përqendrohen mbi dobësitë e identifikuara, përfshirë këtu edhe transparencën e Buxhetit.

Gatishmëri: (3)
Progres (1)

Gatishmëri: (3)
Progres (1)

2011	Progres i kufizuar.
2012	Përgjithësisht, progres i caktuar; progres në efikasitetin e sistemit gjyqësor, i kufizuar në pavarësi dhe cilësi
2013	KAPITULLI 23 Progres i caktuar, nevojiten përpjekje plotësuese për sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe të adresohet problemi i procedurave të gjata gjyqësore.
2014	Vendi ka zbatuar numër të madh të ndërhyrjeve reformiste në këtë fushë, si dhe janë krijuar strukturat juridike dhe administrative. Megjithatë, ekziston rreziku i kthimit prapa në fushën e jurisprudencës. Ekziston pavarësi strukturore kundrejt pavarësisë funksionale të gjyqtarëve. Duhet të avancohet cilësia e drejtësisë dhe standardet për dhënien e shërbimeve qytetarëve. Njëra nga sfidat kryesore është rritja e shqetësimit lidhur me selektivitetin e gjyqësorit dhe ndikimin mbi gjyqësorin dhe organet me autorizime të veçanta. Prezumimi i pafajësisë nuk është kuptuar dhe respektuar plotësisht nga ana e autoriteteve. Ekzistojnë dyshime brenda dhe jashtë shtetit për ndikim të mundshëm politik mbi procese të caktuara gjyqësore.
2015	KAPITULLI 23 Sistemi gjyqësor në vend është në nivel të caktuar të gatishmërisë. Megjithatë, ka regres në gjendjen e saj. Rezultatet e reformave të zbatuara në dekadën e fundit janë dëmtuar nga ndërhyrja reale dhe potenciale politike në punën e gjyqësorit. Mbetet për t'u zgjidhur çështjet veç më të hapura, të shënuara në raportet e kaluara. Prioritetet urgjente të reformave vërtetojnë çka duhet të ndërmerret shteti që të shmanget nga regressi i mëtejshëm. Strukturat legjislative dhe institucionale që janë veç më të vendosura, duhet të shfrytëzohen me vullnet të mirë dhe në frymë të asaj për çka janë të projektuar.

Sistemi gjyqësor në vend ka një nivel të caktuar të përgatitjes. Megjithatë, kthimi pas vazhdon edhe më tutje dhe kjo paraqet një problem serioz. Reformat e zbatuara gjatë dekadës së fundit vazhdojnë të cenohen nga ndërhyrja politike në punën dhe emërimet në sistemin gjyqësor. Nuk ka progres sa u përket rekomandimeve të vitit të kaluar ose sa u përket çështjeve të identifikuara në raportet paraprake dhe në “Prioritetet Urgjente të Reformave”. Puna e Prokurorisë Speciale nuk duhet të pengohet. Gjatë vitit të ardhshëm vendi posaçërisht duhet: - Ta depolitizojë sistemin e emërimeve dhe promovimit të praktikës, jo vetëm në ligj; - Të siguroj mbështetje të plotë dhe resurse për Prokurorin Special; - Ta reformojë sistemin e procedurave disiplinore dhe të shkarkimit të gjyqtarëve, në përputhje me rekomandimet e BE dhe Komisionit të Venecias; - Të zhvillojë strategji serioze për reforma në jurisprudencë dhe në plan veprimin për zgjidhjen e mangësive të tjera në mënyrë të qëndrueshme; - Ta përmirësojë planifikimin strategjik, vlerësimin e nevojave, menaxhimin me resurset dhe shpërndarjen në kuadër të sektorit të drejtësisë, përfshirë edhe në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

2011	Progres i kufizuar
2012	Progres i vogël evident
2013	Korniza ligjvënëse është kompletuar dhe nevojiten angazhime për sigurimin dhe përmirësimin e efikasitetit të gjykatave në raport me monitorimin e rasteve të paraqitura pranë prokurorisë publike, në lidhje me sanksionimin dhe shpejtësinë e procedurave.
2014	Ekziston rreziku nga kthimi prapa në fushën e luftës kundër korrupsionit. Korniza ligjore dhe institucionale e vendit gradualisht kalon në dosje të suksesit, sidomos në zbatimin e hetimeve, prokurori dhe aktgjykime. Sugjerohet në nivelin e pakënaqshëm të të planifikimit strategjik dhe përmbushjes së fushave kryesore – prokurime publike, korrupsion politik dhe korrupsion në nivel të lartë. Përkushtimi i rritur politik është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe.
2015	KAPITULLI 24 Vendi është në nivel të caktuar të gatishmërisë në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar. Nuk është arritur asnjë progres. Kuadri ligjor në masë të madhe është i harmonizuar me standardet evropiane. Kapaciteti i përgjithshëm për menaxhim me krimin e organizuar është i rritur me ngritjen e njësive të specializuara në kuadër të policisë dhe prokurorisë publike. Megjithatë, mbetet të punohet akoma më shumë për përmisimin e efektivitetit në zbatimin e ligjit nga kjo fushë.
2016	Vendi ka nivel të caktuar të përgatitjes. Korniza ligjvënëse dhe institucionale u zhvillua gjatë periudhës kohore më shumë se një dekadë, si dhe dosjet e arritjes së parandalimit dhe ndjekjes. Nuk është arritur progres për çështjet e hapura gjatë vitit të kaluar ose për rekomandimet e vitit të kaluar. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz. Ulje e konsiderueshme është vërejtur edhe në aktivitetet për parandalim dhe represion. Kapacitetet për luftimin efikas të korrupsionit vazhdojnë të cenohen nga ndërhyrjet politike në punën e organeve, duke e pamundësuar veprimin dhe trajtimin e tyre proaktiv dhe joselektiv, veçanërisht në rastet e nivelit të lartë (“Prioritetet Urgjente të Reformave”).

Në zgjidhjen e mangësive të apostrofuara, gjatë vitit të ardhshëm vendi duhet t'i përkushtojë vëmendje të veçantë:

- Manifestimit të vullnetit të mirëfilltë politik përmes sigurimit të autonomisë së nevojshme të organeve ligjzbatuese, personelit të specializuar dhe pajisjes dhe me përcaktimin e qartë të objektivave dhe indikatorëve konkret për matjen e arritjeve ose mosukseseve;
- Shqyrtimit të statusit dhe përbërjes së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) me qëllim që të bëhet më transparent, i bazuar në merita dhe i pavarur nga partitë politike;
- Përmirësimit të vetëdijes publike dhe besimit në luftën kundër korrupsionit përmes rritjes së vizibilitetit të masave anti-korrupsion dhe rezultateve të arritura;
- Zhvillimit të evidencës autentike për luftë kundër korrupsionit në nivel të lartë, duke e përfshirë edhe kthimin e mjeteve (siç është theksuar në “Prioritetet Urgjente të Reformave”);
- Zbatimit të kornizës efektive ligjore për mbrojtjen e denoncuesve të korrupsionit / “bilbilfryrësve” konform standardeve evropiane (siç është potencuar në “Prioritetet Urgjente të Reformave”) dhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

Kritere/ Nënkritere / Kapitulli

Lufta kundër krimit të organizuar (fushë e re nga ky vit)

2011

2012

2013

2014

2015

Vendi është i goditur nga fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë dhe radikalizimit. Është e nevojshme një strategji gjithpërfshirëse dhe efektive për të luftuar parandalimin dhe shmangien/kundërshtimin e radikalizimit, në bashkëpunim të ngushtë me liderët fetarë dhe kunitetet, punonjësit social dhe punonjësit e rradhës së parë, sistemin arsimor dhe organizatat rinore. Fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë kërkon qasje të përkushtuar nga organet e inteligjencës dhe organet për zbatimin e ligjit njëherit edhe qasje koherente ligjore në drejtim të shkelësve ligjor.

2016

Vendi ka arritur nivel të caktuar të përgatitjes në luftën kundër krimit të organizuar. Korniza ligjore, në masë të madhe, është harmonizuar me standardet evropiane. Nuk ka progres sa u përket rekomandimeve të vitit të kaluar. Seksion i veçantë për krimin ekonomik dhe korrupsionin u themelua në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Megjithatë, në këtë fushë duhet të punohet më shumë në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti i organeve ligjzbatuese. Gjatë zgjidhjes së mangësive të nënvizuara, në periudhën e ardhme vendi duhet t'i përkushtojë vëmendje të veçantë: - Arritjes së rezultateve më të mira në luftën kundër pastrimit të parave dhe në përmirësimin e kapaciteteve dhe ekspertizës për zbatimin e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronës në mënyrë më sistematike; -Vendosjes së mekanizmit të pavarur, të jashtëm dhe transparent për mbikëqyrje nga ana e policisë; -Përforcimit të angazhimeve për përmirësimin e bashkëpunimit midis organeve të ndryshme për zbatimin e ligjit, përmes inkorporimit të Qendrës Koordinative Nacionale për luftë kundër krimit të organizuar me operacionalizim të plotë; -Rishikim të kornizës ligjore dhe teknike për ndjekjen e komunikimeve dhe rritjen e efikasitetit të masave të veçanta hetuese për zbatimin autentik/ të besueshëm të qëllimeve të ligjit (siç është theksuar në "Prioritetet Urgjente të Reformave").

Gatishmëri: 2,
Progres: 0

Gatishmëri: 2,
Progres: 0

2011

2012

2013

2014

KAPITULLI 24

2015

Vendi është i goditur nga fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë dhe radikalizimit. Është e nevojshme një strategji gjithpërfshirëse dhe efektive për të luftuar parandalimin dhe shmangien/kundërshtimin e radikalizimit, në bashkëpunim të ngushtë me liderët fetarë dhe kunitetet, punonjësit social dhe punonjësit e radhës së parë, sistemin arsimor dhe organizatat rinore. Fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë kërkon qasje të përkushtuar nga organet e inteligjencës dhe organet për zbatimin e ligjit njëherit edhe qasje koherente ligjore në drejtim të shkelësve ligjor.

2016

2011	Ekziston kornizë ligjore, kornizë jo e plotë institucionale; progres i kufizuar në avancimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut
2012	Progres i kufizuar në avancimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut
2013	KAPITULLI 23 Progres i mëtutjeshëm me ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi Seksual dhe Protokollit të Tretë Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.
2014	KAPITULLI 23 Është realizuar progres i mëtutjeshëm.
2015	KAPITULLI 23: Kudri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në masa të mëdha është në përputhje me standardet evropiane, por fokusi duhet të vihet mbi zbatimin e saj. Organet e ndryshme që janë të kyçur në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave njerëzore nuk kanë personel e mjete të mjaftueshme financiare, dhe ndonjëherë shfaqet koordinim i dobët. Dobësitë e përgjithshme të standardeve në realizimin e të drejtave njerëzore më së shumti i godisin grupet e cënuara dhe të marginalizuara në shoqëri, duke i përfshirë fëmijët dhe të miturit (juveniles), personat me aftësi të kufizuara, romët dhe komunitetin LGBT. Dobësitë veçanërisht ndikojnë në fushat vijuese: -Sistemi i burgjeve akoma më tej është i menaxhuar dobët dhe mungojnë burime financiare dhe njerëzore; -Josanksionimi i policisë duhet të adresohet përmes krijimit të një mekanizmi të pavarur për mbikëqyrje; -Përkundër përmisimeve në kuadrin ligjor, liria e shprehjes është problematike në praktikë.
2016	Legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në masë të madhe, është harmonizuar me standardet evropiane, por ndonjë herë ligjet nuk zbatohen në mënyrë të drejtë ose plotësisht. Organet e përfshira në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut nuk kanë kuadër të mjaftueshëm dhe mjete financiare, ata kanë koordinim të keq, ndërsa në disa raste, nuk konsiderohen si të pavarura. Dobësitë në zbatimin e standardeve për të drejtat e njeriut vazhdojnë të ndikojnë, para së gjithash, mbi grupet vulnerable dhe të marginalizuara të shoqërisë, duke i përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, personat me handicap, romët dhe komunitetin LGBT.

Mangësitë, posaçërisht i përfshijnë këto fusha:

- Probleme serioze në praktikë ekzistojnë lidhur me lirinë e shprehjes për shkak të zbatimit të pabarabartë të ligjit dhe pengesave politike.
- Sistemi penitenciar nga aspekti kadrovik edhe më tutje është i pa-ekipuar dhe keqadministruar, e që rezulton me shkelje sistematike të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- Vendosja e mekanizmit të pavarur për mbikëqyrje është një nevojë e cila shpeshherë përsëritet, e cila akoma nuk është zgjidhur, ndërsa nevojitet të mundësojë që ankesat për keqtrajtimin policorë të trajtohen në mënyrë serioze dhe rrënjësore.

Kritere/ Nënkritere / Kapitulli

Të drejta civile dhe politike me theks mbi lirinë e shprehjes dhe mediat e pavarura

2011	Progres i kufizuar
2012	Progres i caktuar i mëtutjeshëm
2013	
2014	<p>Korniza ligjore e të drejtave themelore ekziston por nevojitet fokus i implementimit efektiv. Situacioni në lidhje me lirinë e shprehjes edhe më tej është shumë problematike edhe përkrah vendosjes së legjislativës së re të gjithëpërfshirë kah viti 2013, mbas konsultimit ekstenziv publik dhe këshillimit me shoqatat ndërkombëtare. Ekziston kontrolli indirekt qeveritar i mediave përmes emitimit të reklamave në mediat afër qeverisë.</p>
2015	<p>Këtë vit fokusi është në lirinë e shprehjes. Vendi ka një nivel të caktuar të gatishmërisë në lidhje me lirinë e shprehjes. Korniza legislative është e rishikuar brenda disa viteve të fundit dhe është e harmonizuar me acquis dhe standardet ndërkombëtare. Megjithatë, liria e shprehjes dhe mediat mbeten sfidë në kulturën aktuale mediatike dhe në klimën politike. Vendi pësoi regres brenda vitit të kaluar.</p>
2016	<p>Vendi ka nivel të caktuar të përgatitjes. Legjislacioni, në masë të madhe, është harmonizuar me legjislacionin evropian dhe me standardet ndërkombëtare, edhe pse ka kërkesa për reforma të mëtutjeshme në vend. Liria e shprehjes dhe gjendja e mediave është një sfidë serioze në kontekstin e klimës aktuale politike. Nuk ka progres në këtë fushë gjatë pjesës më të madhe të vitit të kaluar. Të dhënat relevante për reklamën qeveritare, që mund të paraqes mjet për ushtrimin e ndikimit mbi radiodifuzerët, akoma nuk janë publikuar nga ana e autoriteteve. Raportim të balancuar dhe të shumëllojshëm nga ana e mediave mejnstrim akoma nuk ka, edhe pse kishte disa shenja inkurajuese gjatë stinës së verës lidhur me raportimin nga ana e servisit radiodifuziv publik dhe nga disa kanale private. Gjatë vitit të ardhshëm vendi posaçërisht duhet: - Të ketë rezultate të dukshme nga reformat të cilat zbatohen në kuadër të servisit radiodifuziv publik, me qëllim të zgjidhjes së mungesës së pavarësisë politike dhe mungesës së raportimit të balancuar ("Prioritetet Urgjente të Reformave"); - Të sigurojë transparencë të plotë të reklamave qeveritare, dhe jo vetëm për shpenzimin e financave publike, por edhe të shfrytëzuesve të tyre dhe përbajtjeve ("Prioritetet Urgjente të Reformave"); - Të sigurojë transparencë, të ketë qasje në raportime objektive dhe të sakta dhe në perceptime të ndryshme përmes mediave mejnstrim, veçanërisht përmes servisit radiodifuziv publik; - Të gjithë faktorët mediatik duhet t'i ndërmarrin detyrimet e tyre përkatëse për sjellje profesionale.</p>

Gatishmëri: 2,
Progres: -1

Gatishmëri: 2,
Progres: 0

2011	Janë vendosur të drejta ekonomike dhe sociale, progres i caktuar i mëtutjeshëm
2012	Progres i caktuar
2013	
2014	Progres i caktuar
2015	
2016	

2011

2012

2013

Nuk ka progres

2014

Në lidhje me të drejtat e komunitetit LGBT nevojiten përpjekje të mëdha për ritje të vetëdies për respektimin e diversitetit në shoqëri dhe largimin e jotolerancës që zgjerohet përmes rrjeteve sociale.

Kryesit të incidenteve akoma nuk janë të ndjekur penalisht. Të dhënat për raport të hetimit dhe të ndjekjes të gjuhës së urrejtjes dhe veprat nga urrejtja nuk mblidhen sistematikisht.

Nevojitet harmonizim i Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi me Eu-acquis, për shkak se në Ligjin nuk është parashikuar orientimi seksual për diskriminim si dhe trajnim i prokurorëve publik dhe gjyqëtarëve.

2015

Kuadri legjislativ akoma duhet të harmonizohet me acquis në fushën e diskriminimit në batë të orientimit seksual. Është e nevojshme ngritje e vetëdijes publike për punën e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Komisioni s'ka resurse dhe personel të mjaftueshëm për ta publikuar punën e saj dhe akoma më tej ekziston shqetësim për pavarësinë e saj.

Individët që janë pjesë e komunitetit LGBT, vazhdojnë të vuajnë nga diskriminimi dhe përmbajtjet homofobike të mediave, në botën virtuale por edhe në atë reale. Në gusht, Parlamenti hedhi poshtë projekt-amandamentin e rregullativës së legjislacionit për anti-diskriminim, me çka do të ndalohej çdo formë e diskriminimit direkt ose indirekt mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Janë të nevojshme përpjekje të konsiderueshme për rritjen e vetëdijes, respektimit të diversitetit në shoqëri dhe kundërshtimit të intolerancës. Kjo mund të arrihet përmes fushatave publike dhe trajnimeve në agjencionet policore, te prokurorët, gjykatësit dhe profesionistët e shëndetit. Pavarësisht thirrjeve nga organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar që autorët e krimit të ndiqen penalisht, asnjë nga sulmet nuk është hetuar plotësisht.

2016

2011	Progres i caktuar
2012	Progres i caktuar
2013	Mungesa e resurseve financiare, bashkëpunimi jopërkatës midis institucioneve, si dhe nevoja për implementimin proaktiv të politikave relevante (p.sh. Strategjia e Romëve) e kufizojnë progresin në aspekt të respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve.
2014	Progresi në mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve edhe më tutje pengohet për shkak të financave të pamjaftueshme dhe resurseve njerëzore, si dhe për shkak të bashkëpunimit joadekuat midis organeve kompetente.
2015	Është miratuar strategjia e re për Romët 2015-2020 dhe janë përforcuar kapacitetet e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Megjithatë, romët janë të rrezikuar ngase kanë probleme me qasjen deri në beneficione sociale si pasojë e mungesës së dokumentacionit administrativ. Rrëndë vërrehet progres në aspekt të përfaqësimit politik, mbulimit mediatik në gjuhë romë dhe statusit të gjuhës rome në komunat ku shumica e popullsisë janë Romë. Segregacioni, stereotipet dhe diskriminimi vazhdojnë të mbizotërojnë. Janë regjistruar ankesa nga Romët të cilët kanë qenë të penguar që ta lëshojnë shtetin. Numër i madh jetojnë në kushte substandarde dhe ballafaqohen me probleme në qasjen drejt arsimit, strehimit, shëndetësisë dhe punësimit.
2016	

2011	Progres i caktuar
2012	
2013	Marrëveshja është në fuqi nga viti 2001, megjithatë, nevojitet akoma progres në lidhje me çështjet sistemore që kanë të bëjnë me decentralizimin, mosdiskriminimin, përfaqësimin e drejtë, përdorimin e gjuhëve dhe arsimin.
2014	Konstatohet se “dominon mungesa e besimit midis bashkësive”, si dhe se “ngjarjet dhe incidentet lehtësisht shkaktojnë tensione”. Qeverisë i rekomandohet të ketë qasje më proaktive dhe të përbashkët në promovimin e shoqërisë multietnike inkluzive. Vihet në pah nevoja që të kompletohet analiza e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, si dhe të jepen rekomandime.
2015	Marrëveshja Kornizë e Ohrit vazhdoi të sigurojë bazë për marrëdhëniet mes komuniteteve. Agjencia për Mbrojtjen e Bashkësive Joshumicë, Drejtoria e Arsimit në gjuhët e komuniteteve dhe Zyra për promovimin e kulturës së bashkësive joshumicë ballafaqohen me burime të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare. Bashkëpunimi ndërinstytucional vazhdon të jetë i dobët. Masat sistematike në numër të madh janë të implementura përmes fondeve nga donatorët. Në mënyrë të kufizuar përdoret politika për arsim të integruar. Masat kundër ndarjes në baza etnike në shkolla nuk janë të mjaftueshme. Ekzistojnë më shumë forma të diskriminimit mbi të cilat masat e ndërmarra, duke përfshirë edhe mediat, janë joefikase.
2016	Decentralizimi i pushtetit është element kyç i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Financimi i pamjaftueshëm nga buxheti qendror dhe kapaciteti i ulët i arkëtimit të tatimeve lokale e komprometon kapacitetin e disa komunave që t'i kryejnë obligimet e tyre. Korniza ligjore e vetëqeverisjes lokale duhet të rishikohet. Zhvillimi i balancuar rajonal është njëri nga elementët kryesor të MKO. Plan veprimi për vitet 2016-2019 parashikon shpërndarje më transparente dhe të balancuar të fondeve nacionale. Buxheti për zhvillimin rajonal për vitin 2016 u rrit dyfish, ndërsa buxheti për vitin 2017 parashikon edhe një rritje, por megjithatë edhe kjo nuk do të mjaftojë. Marrëveshja Kornizë e Ohrit duhet të shqyrtohet në mënyrë inkluzive dhe transparente, ndërkaq rekomandimet eventuale duhet të zbatohen. Implementimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO) akoma është shumë i politizuar. Me mbështetjen ndërkombëtare, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, përpiloi raport me rekomandime dhe ia dërgoi Qeverisë në muajin dhjetor të vitit 2015. Tani për tani, nuk kemi të dhëna të detajuara për monitorimin e gjendjeve. Tensionet ndëretnike të shkaktuara nga potencimi publik i simboleve fetare dhe etnike u qetësuan nga liderët politikë dhe udhëheqësit fetarë.

2011	Partner konstruktiv në rajon, marrëdhënie bilaterale të avancuara, çështja e emrit vazhdon të ndikojë në marrëdhëniet me Greqinë
2012	Në mënyrë aktive merr pjesë në bashkëpunimin rajonal dhe vazhdon me avancimin e marrëdhënieve bilaterale me fqinjët. Çështja e emrit vazhdon të ndikojë mbi marrëdhëniet me Greqinë; nevojitet sjellje konstruktive në qasjen ndaj fqinjëve
2013	Në mënyrë aktive merr pjesë në bashkëpunimin rajonal dhe vazhdon me avancimin e marrëdhënieve bilaterale me fqinjët. Ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, përfshirë edhe zgjidhjen e çështjes së emrit, mbetet çështje kryesore. Ka çështje të hapura në negociatat për marrëveshje bilaterale me Bullgarinë. Nevojitet qasje konstruktive në marrëdhëniet me fqinjët dhe duhet të shmangen aksione dhe deklarata të cilat mund të kenë ndikim negativ.
2014	Në mënyrë aktive merr pjesë në bashkëpunimin rajonal dhe vazhdon me avancimin e marrëdhënieve bilaterale me fqinjët. Ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, përfshirë edhe zgjidhjen e çështjes së emrit mbetet çështje kryesore. Ka çështje të hapura në negociatat për marrëveshje bilaterale me Bullgarinë.
2015	Në mënyrë aktive merr pjesë në iniciativa rajonale. Theks të veçantë ka bashkëpunimi rajonal në suaza të procesit të Berlinit me vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6) për intensifikimin e bashkëpunimit mes tyre dhe BE-së. Maqedonia vazhdoi të luajë një rol përgjithësisht konstruktiv në marrëdhëniet bilaterale me vendet e tjera që aspirojnë të anëtarësohen në BE dhe me shtetet anëtare fqinje të BE-së. Marrëdhëniet me Bullgarinë dhe Greqinë akoma më tej janë mbesin çështje të hapura.
2016	Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore janë pjesë esenciale të procesit të përafrimit të vendit drejt BE-së. Vendi vazhdon në mënyrë aktive të marr pjesë në iniciativat rajonale, siç është Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL), Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, CEFTA. “6-ja Ballkanike – Perëndimore”, Marrëveshja për Komunitetin Energjetik, Marrëveshja për Fushën e Përbashkët Evropiane të Navigacionit, Iniciativa e Evropës Qendrore (CEI), Regi +Q6 Iniciativa Zonale për Migracion dhe Azil (MARRI) dhe REKOM. Vendi mbeti i përkushtuar në mënyrë konstruktive mbi marrëdhëniet bilaterale me vendet e tjera të procesit të zgjerimit dhe me vendet fqinje anëtare të Bashkimit. Marrëdhëniet me Bullgarinë vazhduan të jenë nën ndikimin e divergjencave, para së gjithash, lidhur me interpretimin e historisë, megjithatë u organizuan dhe u mbajtën një numër i madh i vizitave të nivelit të lartë. Marrëdhëniet me Greqinë edhe më tej janë nën ndikimin e çështjes së emrit. Nuk pati kurrfarë biseda formale për këtë çështje nën patronazhin e KB-së gjatë periudhës së kaluar të raportimit. Ministrat e Punëve të Jashtme patën takime bilaterale dhe multilaterale. Masat e ndërtimit të mirëbesimit dhanë rezultate të prekshme.

2011	Në masë të mjaftueshme vazhdon t'i përmbush kriteret politike
2012	Në masë të mjaftueshme vazhdon t'i përmbush kriteret politike
2013	Në masë të mjaftueshme vazhdon t'i përmbush kriteret politike
2014	Në përgjithësi, duke pasur parasysh progresin kumulativ që ka arritur vendi, Komisioni konsideron se kriteret politike vazhdojnë të plotësohen në mënyrë të mjaftueshme dhe mban rekomandimin për të hapur negociatat e aderimit, por shpreh keqardhje për ngecjet e vitit të kaluar.
2015	<p>Duke pasur parasysh progresin e deritanishëm në zbatimin e marrëveshjes politike nga muaji qershor/korrik, Komisioni është i përgatitur që ta japë rekomandimin e vet për hapjen e negociatave të aderimit me Republikën e Maqedonisë.</p> <p>Megjithatë, kusht për këtë do të jetë zbatimi i vazhdueshëm i marrëveshjes politike nga muaji qershor/korrik dhe progresi i konsiderueshëm në zbatimin e prioriteteve urgjente të reformave. Kjo çështje do të adresohet edhe njëherë pas zgjedhjeve.</p>
2016	<p>Hapat pozitivë të ndërmarra kohë më parë lidhur me Marrëveshjen e Përzhinos janë mundësi e mirëfilltë për liderët politikë përfundimisht ta tejkalojnë krizën e stërzgatur dhe t'u qasen çështjeve sistemore.</p> <p>Duke e pasur parasysh këtë, Komisioni është i gatshëm ta jap rekomandimin e vet për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Republikën e Maqedonisë. Megjithatë, kusht për këtë është implementimi i Marrëveshjes së Përzhinos, para së gjithash, mbajtja e zgjedhjeve kredibile; dhe progres i konsiderueshëm në implementimin e Prioriteteve Urgjente të Reformave.</p>

2011	
2012	
2013	Vendi edhe është i avancuar dhe është aritur përparim kah ekonomia funksionale tregëtare
2014	Republika e Maqedonisë është e avancuar dhe me disa fushë është aritur përparim i mëtutjeshëm në krijimin e ekonomisë funksionale tregëtare.
2015	“Maqedonia është e përgatitur mirë në zhvillimin e ekonomisë funksionale të tregut. Në tërësi, nuk ka pasur progres.”
2016	Maqedonia është e përgatitur mirë sa i përket ekonomisë funksionale të tregut. Megjithatë, gjatë periudhës raportuese nuk është shënuar progres.

2011	
2012	
2013	Është ruajtur konsensus i gjerë për politikat themelore ekonomike.
2014	Është ruajtur konsensus politik për bazat e ekonomisë së tregut, megjithatë politika ekonomike dhe menaxhimi me konsumin publik më shumë janë udhëhequr nga motivet ad hoc, në vend që të udhëhiqen nga nevojat afatgjate të ekonomisë.
2015	"Qeveria mbetet e përkushtuar në arritjen e reformave ekonomike në treg, duke tërhequr investime të huaja dhe duke zhvilluar sektorin privat. Qeveria realizoi progres të ulët në reformat strukturore të tregut të punës dhe ka regres në disiplinën fiskale."
2016	Qeveria mbetet e përkushtuar ndaj promovimit të rritjes dhe punësimeve të cilat bazohen në politikat e ekonomisë së tregut. Udhëzimet e Programit për reforma ekonomike nga data 12 maj të vitit 2015 të cilat kanë të bëjnë me çështje makro-fiskale nuk janë marrë parasysh, ndërsa udhëzimet për politikat e tregut të punës dhe reformat strukturore janë marrë parasysh vetëm pjesërisht.

2011	
2012	
2013	Rritja e ripërtërirë e ekonomisë mbetet ngushtë e lidhur me investimet, me përforsimin gradual të sektorit të jashtëm, si dhe me mbështetje marginale nga konsumi privat.
2014	Rritja e prodhimtarisë duhet të ketë bazë më të gjerë, ndërsa deficiti i jashtëm është e mundur përsëri të rritet përkohësisht për shkak të importit investues.
2015	"Ambienti makroekonomik u përforsua në mënyrë plotësuese, por dobësitë kyçe mbeten një burim i madh shqetësimi.
2016	"Ekspansioni ekonomik, i përshpejtuar në vitin 2015, u ngadalësua në vitin 2016 në kushte të krizës politike. Ishin nën kontroll ekspozimet e jashtme afatshkurtra.

2011

2012

2013

Menaxhimi fiskal dhe disiplina fiskale janë përkeqësuar dhe do të ishte i dobishëm zbatimi i strategjisë afatmesme. Miksi i politikave pjesërisht është përkeqësuar. Edhe pse politika monetare siguroi mbështetje kyç për stabilitetin makroekonomik, disiplina fiskale u dobësua dhe borxhi edhe më tutje shënon rritje. Financat publike mund të kontribuojnë në drejtim të stabilitetit më të madh, për shembull, përmes subordinimit më të mirë të prioritetëve të konsumit lidhur me sfidat strukturore, me fokus të veçantë mbi rritjen e konsumit publik. Përveç kësaj, rritja e shpejtë e borxhit të financuar kryesisht nga jashtë, e rrit vulnerabilitetin e shtetit.

2014

Disiplina fiskale duhet të përmirësohet, ndërkohë që ekziston hapësirë e konsiderueshme për përmirësimin e transparencës fiskale. Planet qeveritare për konsolidimin fiskal duhet të mbështeten me masa konkrete.

2015

"Disiplina fiskale sërisht ka pësuar regres në vitin 2014 dhe 2015, duke treguar nevojën që të përmisohet planifikimi afatmesëm i shpenzimeve. Borxhi publik është rritur në mënyrë të konsiderueshme brenda viteve të fundit, teksa amandamentet në ligjin mbi borxhin publik shkaktojnë shqetësim në transperencë."

2016

Niveli i borxhit publik rritej me shpejtësi.

2011

2012

2013

Përderisa regjistrimi dhe puna e sektorit afarist janë lehtësuar në mënyrë shtesë, dobësitë gjatë falimentimit dhe procedurat e likuidimit edhe më tej mbeten pengesë e konsiderueshme për investime dhe akses deri në financa.

2014

Përderisa fillimi i biznesit bëhet pak më i lehtë, mbeten vështirësitë gjatë fitimit të lejeve. Dalja nga tregu mbetet e gjatë edhe pse Qeveria ka ndërmarrë hapa reformuese në drejtim të mirëfilltë.

2015

"Themelimi i biznesit është lehtësuar pak, por dalja nga tregu mbetet akoma i vështirë dhe i komplikuar.

Zbatimi i masave të projektit ""i gjilotina rregullatore"" në vazhdimësi përparon sa i përket lehtësimit të regjistrimit të bizneseve. Progresi është më i kufizuar në thjeshtësimin e daljes nga tregu."

2016

Zhvillimi i sektorit afarist vuan nga zbatimi i dobët dhe i pabarabartë i ligjeve.

2011	
2012	
2013	Sistemi juridik, sa i përket ekonomisë funksionale të tregut, në masë të madhe është vendosur, por mbeten dobësitë lidhur me procedurat e gjata, zbatimi i kontratave dhe korrupsioni.
2014	Sistemi juridik, sa i përket ekonomisë funksionale të tregut, në masë të madhe është vendosur, por në praktikë rritet joefikasiteti përmes procedurave të gjata të cilat e pengojnë zbatimin e ligjeve. Ndryshimet e shpeshta të ligjeve krijojnë pasiguri juridike.
2015	"Ndryshimet e shpeshta legislative, aplikimi i pabarabartë i ligjeve dhe zbatimi i vështirë i marrëveshjeve ka ngarkuar aktivitetet e biznesit. Bashkëpunimi mes qeverisë dhe sektorit të biznesit viteve të fundit ka rënë."
2016	Kapacitetet institucionale për zbatimin e ligjeve janë të dobëta. Pjesëmarrja joformale e ekonomisë është e madhe dhe ndikon mbi konkurrencën e sektorit formal.

2011	
2012	
2013	Ekonomia kryesisht menaxhohet nga ana e sektorit privat me rol të kufizuar të shtetit, edhe pse pjesëmarrja e pronësisë publike është rritur në mënyrë të pakonsiderueshme.
2014	Pjesëmarrja e shtetit në ekonomi dhe përcaktimi i çmimeve mbetet prudent.
2015	Pjesa e sektorit publik në ekonomi ka qëndruar kryesisht i pandryshuar në masë të madhe.
2016	Pjesëmarrja e sektorit publik në ekonomi edhe më tej është nën kontroll, edhe pse politika e diskrecionit të ekzekutimit të Qeverisë krijon shqetësime. Çmimet e energjisë, në masë të madhe, i përcakton Komisioni Rregullator për Energjetikë.

2011

2012

2013

Edhe pse ligjet për ndihmë shtetërore janë përforcuar, ekziston mungesë e transparencës në lidhje me detajet e implementimit dhe shumat, për shkak të mangësive gjatë informimit.

2014

Përkundrejt pjesëmarrjes së ulët të shtetit në ekonomi, legjislacioni i përmirësuar për ndihmë shtetërore dhe derregullimi i mëtutjeshëm i tregut të energjisë elektrike, ndikimi i shtetit mbi konkurrencës përmes implementimit të instrumenteve të tjerë të politikës, me sa duket shënon rritje.

2015

Edhe pse pjesa e qeverisë në ekonomi ka mbetur i moderuar, ndikimi mbi konkurrencën në sektorin privat rritet përmes rregulloreve dhe subvencioneve.

2016

2011

2012

2013

2014

2015

2016

Procesi i privatizimit është në fazë të avancuar. Në vitin 2015 nuk pati privatizime dhe numri i ndërmarrjeve, të cilat ishin pjesërisht ose tërësisht në pronë të shtetit, ngelën të pandryshuara në raport me vitin e kaluar.

2011

2012

2013

Sektori financiar mbetet i kapitalizuar mirë dhe likuid. Megjithatë, rritja kreditore është e ngadalshme dhe kreditë jofunksionale paraqesin sfidë të madhe.

2014

Sistemi financiar mbetet stabil, ndërsa kapacitetet mbikëqyrëse janë përforcuar. Prapë se prapë aksesimi deri te financat mbetet i vështirë dhe segmentet jobankare të tregut duhet edhe më tutje të zhvillohen me qëllim që të zgjerohen mundësitë e financimit të sektorit privat. Duhet të vazhdohet me ndërmarrjen e masave përmes së cilave do të përmirësohet kanali i borxheve bankare, përfshirë edhe pastrimin e portofolave jofunksionale kreditore.

2015

Sektori bankar qëndron stabil edhe përkundër nivelit të lartë të kredive joperformuese

2016

Sektori bankar manifeston rezistencë lidhur me rrishtën e kreditorit. Në sektorin financiar akoma dominojnë bankat, pjesëmarrja e të cilave në mjetet e sektorit është rreth 90%.

2011

2012

2013

Përveç disa përmirësimeve të veçanta të shifrave, në tregun zyrtar të punës, politika e tregut të punës pati sukses të kufizuar në zgjidhjen e çështjes së papunësisë së madhe. Sfidat strukturore të tregut të punës duhet të zgjidhen.

2014

Reformat për ballafaqimin me rigjiditetet strukturore të tregut të punës arritën vetëm progres të kufizuar. Punësimi i punëtorëve duhet të përmirësohet përmes masave strukturore, si dhe përmes targetimit më të mirë të masave aktive në tregun e punës.

2015

"Kushtet në tregun e punës akoma janë të ngarkuara me pengesa strukturore.

2016

Dobësitë strukturore e pengojnë funksionimin e tregut të punës. Pjesëmarrja në fuqinë e punës edhe më tej është modeste. Ekonomia joformale zë pjesë të madhe në punësim, edhe pse shënon rënie.

2011

2012

2013

Vendi në afat të mesëm duhet të jetë i aftë të përballohet me presionet e konkurrencës dhe fuqitë e tregut në Bashkimin, në qoftë se në mënyrë energjike i shqyrton programet reformike për të zvogëluar mangësitë e rëndësishme strukturore.

2014

Që të përballohet me forcat e konkurrencës dhe forcat e tregut e Bashkimit në afat të mesëm, vendi duhet ti zgjidh ballafaqimet kryesore përmes shqyrtimit të përcaktuar të reformave strukturore.

2015

“Ekonomia është mesatarisht e përgatitur që të ballafaqohet me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian. Progres i caktuar që i realizuar rrezh trajtimit me mangësitë në drejtim të kapitalit njerëzor dhe infrastrukturës fizike.”

2016

Ekziston nivel mesatar i përgatitjes së ekonomisë që të përballtet me presionin e konkurrencës dhe fuqitë e tregut brenda Bashkimit. Është bërë një progres i vogël për stimulimin e inovacioneve dhe investimeve të huaja, ndërsa digjitalizimi shënon përparim të shpejtë.

2011

2012

2013

2014

2015

2016

Nevojiten reforma në arsimin e lartë në mënyrë që të zgjidhet problemi i ofertës joadekuate të aftësive. Shkallët inovative të sektorit privat janë të ulëta.

2011

2012

2013

Ekziston progres gradual në zgjidhjen e nevojave reformiste në sistemin ekonomik. Kapitali mbetet modest, ndërsa konsumi publik fokusohet në masë të pamjaftueshme mbi aktivitetet për zmadhimin e rritjes

2014

Qeveria ka arritur progres të caktuar lidhur me zgjidhjen e mangësive kryesore në alokimin e kapitalit njerëzor dhe fizik në vend, megjithatë sfidat e investimeve, të cilat janë të nevojshme për përsheptimin e rritjes së produktivitetit të punës dhe transformimit strukturor të ekonomisë mbeten të mëdha. Qeveria duhet të vazhdojë ta përmirësojë përbërjen e shpenzimeve përmes projekteve prioritare investuese, në përputhje me potencialin e tyre për produktivitet në bazë të vlerësimit të shpenzimeve.

2015

"Pjesa e punëtorëve të kualifikuar në ekonomi është në rritje, por faktorët strukturorë e kufizojnë rritjen e produktivitetit të punës.

Infrastruktura publike ka nevojë për modernizim."

2016

Kapitali ekonomik duhet të modernizohet. Lidhja rajonale e transportit dhe energjisë është e kufizuar. Është shënuar progres në digjitalizimin e ekonomisë.

2011

2012

2013

Është i dukshëm diversifikimi gradual i prodhimtarisë ekonomike sa i përket vlerës së shtuar dhe eksportit.

2014

"Strukturat sektoriale e ndërmarrjeve në ekonomi janë në stagnim dhe janë të fokusuar në aktivitete me produktivitet të ulët. Rritja e paradokshme e numrit të kompanive të mëdha tregon se pjesëmarrja e aktiviteteve prodhuese të avancuara mund të përforcohet në vitet e ardhshëm, por transformimi i mirëfilltë sektorial mbetet i paarrtshëm."

2015

Struktura sektoriale e ekonomisë mbetet kryesisht në stagnim.

2016

Transformimi strukturor i ekonomisë përparon ngadal.

2011

2012

2013

Integrimi tregtar në BE është avancuar në masë të konsiderueshme. Struktura e eksportit vazhdon të përmirësohet, edhe pse produktet përpunuese tradicionale akoma dominojnë. Konkurrenca ndërkombëtare e çmimeve, në masë të madhe, mbetet e pandryshuar.

2014

Lidhjet tregtare me BE në vitin 2013 shënuan rritje, edhe sa i përket eksportit edhe sa i përket importit, ndërsa BE mbetet me pjesëmarrje më të madhe në investimet e drejtpërdrejta të huaja.

2015

Është realizuar progres plotësues në zhvillimin e lidhjeve më të ngushta me BE-në

2016

Shtojca 4: Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga 2011-2016

Kapitulli	Progresi						Niveli I harmonizimit					
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1. Qarkullimi i Lirë i Mallrave	1	2	1	1	1	1	3	4	4	4	3	3
2. Lëvizja e Lirë e Punëtorëve	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
3. E Drejta e Themelimit dhe Liria e Sigurimit të Shërbimeve	1	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3
4. Qarkullimi i Lirë i Kapitalit	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3
5. Prokurime Publike	1	1	2	1	1	0	5	4	4	4	3	3
6. E drejta e Shoqërive Tregtare	2	2	2	2	1	1	3	3	4	4	4	4
7. E drejta e Pronës Intelektuale	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3
8. Politika e Konkurrencës	1	2	2	2	1	0	3	4	4	4	3	3
9. Shërbimet financiare	2	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3
10. Shoqëria Informatike dhe Mediat	1	1	1	2	1	0	3	3	3	3	4	4
11. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3
12. Siguria e Ushqimit, Politika	2	2	2	1	1	1	4	3	3	3	2	2

Veterinare dhe Fitosanitare												
13. Peshkimi	1	1	1	1	1	2	3	3	3	4	3	3
14. Politika e Komunikacionit	1	1	1	1	1	1	4	3	3	3	3	3
15. Energjia	2	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3
16. Tatimimi	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3
17. Politika ekonomike dhe monetare	3	1	1	1	1	1	4	4	4	4	3	3
18. Statistika	2	1	2	2	1	1	4	3	4	4	3	3
19. Politikat Sociale dhe Punësimi	1	1	1	1	1	1	2	2	1	3	3	3
20. Ndërmarrjet dhe politika industriale	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3
21. Rrjete trans-europiane	1	1	1	1	2	2	4	3	4	4	4	4
22. Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	1	1	1	1	0	1	3	3	2	2	3	3
23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore	1	1	1	1	0	0	3	3	3	4	2	2
24. Drejtësia, Liria dhe Siguria	1	1	1	1	1	1	4	4	4	4	3	3
25. Shkenca dhe Hulmtimi	1	1	2	2	2	1	2	2	2	3	4	4
26. Arsimi dhe kultura	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3

27. Mjedisi jetësor	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	2
28. Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtje shëndetësore	1	1	1	1	1	0	3	3	3	3	3	3
29. Unioni Doganor	2	1	1	1	2	1	4	4	4	4	4	4
30. Marrëdhëniet me Jashtë	1	1	1	1	1	1	4	3	3	3	3	3
31. Politika e jashtme, e Sigurisë dhe Mbrojtjes	2	2	3	1	1	1	5	5	5	3	3	3
32. Kontrolli financiar	1	1	1	1	1	0	2	1	1	3	3	3
33. Dispozitat dinanciare dhe buxhetore	1	1	0	1	1	1	3	1	1	1	1	1

Shënim: Instituti përdor metodologjinë e vet, me ç'rast në pasqyrimin e vlerësimit të përgjithshëm, vlera e kapitujve të veçantë është ponderuar duke e pasur parasysh vëllimin dhe rëndësinë e tyre

Shpjegime për kuantifikimin e vlerësimeve sa i përket progresit dhe përputhshmërisë

Vlerësimet e përdorura për raportet gjer në vitin 2014:

Progres

Vlerësimi	Vlera numerike
Vlerësimi	{-5}-{-1}
Regres	0
Nuk ka progres; nuk ka progres të mëtutjeshëm	1
Nuk ka progres thelbësor; nuk ka progres të veçantë; progres i pakënaqshëm; progres i ngadaltë; progres fillestar, progres i kufizuar	2
Progres i vogël; progres modest, progres i caktuar	3
Progres; progres i mëtutjeshëm	4
Progres i mirë; progres evident; progres i qëndrueshëm; progres i kënaqshëm	5

Niveli i përputhshmërisë

Vlerësimi	Vlera numerike
Nuk ka filluar	0
Faza e hershme; faza shumë e hershme; faza fillestare	1
Nuk ka shënuar progres të madh; shënon progres; progres i ngadalshëm	2
Progres mesatar	3
Progres i avancuar, në fazë të avancuar	4
Progres i mirë	5

Vlerësimet për vitin 2015 dhe 2016, në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian

Vlerësimi - progres	Vlera numerike
Regres	{-5}-{-1}
Nuk ka progres	0
Progres i caktuar	1
Progres i mirë	2
Progres domethënës	3

Vlerësimi për gatishmëri	Vlera numerike
Nuk ka filluar	0
Fazë e hershme e gatishmërisë	1
Nivel i caktuar i gatishmërisë	2
Nivel i moderuar i gatishmërisë	3
Nivel i mirë i gatishmërisë	4
Nivel i lartë i gatishmërisë	5

Për të siguruar krahasueshmëri sipas metodologjisë së re të Komisionit evropian me vlerësime më parë të dhëna, është bërë rivalorizim i vlerave për vitin 2013.

Analizat e Institutit për politikë europiane për raportet e mëparshëm të KE i gjeni në:

- 2015: <https://goo.gl/IQB99q> (MKD); <https://goo.gl/9r7ZTs> (ALB); <https://goo.gl/OF6L7Y> (ENG)
- 2014: <https://goo.gl/p0Ji0J> (MKD); <https://goo.gl/eBjt4v> (ALB); <https://goo.gl/2RkFnU> (ENG)
- 2013: <https://goo.gl/sBwze9> (MKD); <https://goo.gl/sBwze9> (ALB); <https://goo.gl/sBwze9> (ENG)
- 2012: <https://goo.gl/5LkbqQ> (MKD); <https://goo.gl/5LkbqQ> (ALB); <https://goo.gl/ROcPI3> (ENG)
- 2011: <https://goo.gl/6uWzl6> (MKD); <https://goo.gl/ikAhRx> (ALB); <https://goo.gl/f47DTe> (ENG)